**VENDIM**
**Nr. 815, datë 26.11.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 175, DATË 6.3.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË LUSHNJË, TË QARKUT TË FIERIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "k", 5 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën përfundimtare të pronave që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnjë, të qarkut të Fierit, miratuar me vendimin nr. 175, datë 6.3.2012, të Këshillit të Ministrave, bëhet ndryshimi i destinacionit të sipërfaqes 1 300 (një mijë e treqind) $m^2$, truall, pjesë e pronës me numër rendor 175 e me numër pasurie 13/4, sipas planimetrisë bashkëlidhur, nga fusha e përdorimit "Zhvillim ekonomik" për t'u përdorur për ndërtimin e banesave me kosto të ulët në Bashkinë e Lushnjës.
2. Bashkisë së Lushnjës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia e Lushnjës për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT


## EMRI I OBJEKTIT : GODINE BANIMI & SHERBIMI 8 KAT, TIP 83/5

LAGJA "GAFURR MUCO", LUSHNJE SHKALLA 1:500




**POZICIONI KADASTRAL** 8571

NUMRI I PASURISE 13/4



**PLANVENDOSJA NE RAJON**

L."GAFURR MUCO"LUSHNJE SH 1:2500



**MIRATOHET**
**KRYETARI I K.RR.T TE BASHKISE LUSHNJE**
**FATOS TUSHE**

**DREJTOR I URBANISTIKES TE BASHKISE**
**MIMOZA HAXHIU**

INVESTITORI
ENTI KOMBETAR I BANESAVE

**KONDICIONE URBANE :**

| | | |
|---|---|---|
| Siperfaqja e TRUALLIT | 2986 | m² |
| Sip.e Nderrmarjes se Pasurise Publike | 719 | m² |
| Sip. e ndertesave N. te pasurise publike | 456 | m² |
| Sip.e ndertimit kati perdhe | 877.5 | m² |
| Koeficenti i shfrytezimit te territorit | 44.6% | |
| Lartesia max.e objektit | 24 | m |
| Volumi i objektit | 21600 | m³ |
| Distanca nga aksi i rruges mesatarisht | 32 | m |

| | | |
|---|---|---|
| | Inv. ENTI KOMBETAR I BANESAVE | |
| OBJEKTI: GODINA BANIMI 8 KAT L."Gafurr Muço" Lushnje | | A-01 |
| | | 2011 |
| PLANIMETRIA E SHESHIT TE NDERTIMIT | | |